

VENDIM
Nr.533, datë 7.7.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.370, DATË 15.9.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR HAPJEN E MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PRANË SELISË SË NATO-S, BRUKSEL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 15.9.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 2/1, te përbërja e përfaqësisë ushtarake, të shtohet emërtesa:

“- Oficer ndërlidhës i SHIU-t, nënkolonel – kolonel;”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha